

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E GJAKOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	632-26-5571-5-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për **Ndërtimi dhe funksionalizimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

VED GROUP SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

LAGJJA KALABRIA

(Adresa)

PRISHTINË

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+383 49 763 356

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Vlera Thaqi


(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

vedshpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

24.08.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 10.07.2026
Kerkesa për rishqyrtim : 12.08.2026
Refuzimi i kërkeses për rishqyrtim : 13.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po



Jo



Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 28 – Specifikimet teknike
Neni 56 i LPP-së – (Mospërputhja thelbësore me kërkesat e Dosjes së Tenderit)
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne si operator ekonomik në këtë procedurë të prokurimit, paraqesim këtë ankesë, në përputhje me nenin 108 të Ligjit për Prokurim Publik.

Sipas nenit 5 të LPP, afatet kohe duhet të fillojnë në ditë pune dhe të perfundojnë në ditë pune andaj dita e 10 pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim ka qenë me datë 23.08.2026 e diele andaj afati zgjatet me datë 24.08.2026.

PRETENDIMI 1.

Pretendimi 1.

Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka përcaktuar kërkesën:

*“Kamionë me konstruksion kiper me **peshë totale maksimum 1t** (kamioni duhet të ketë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit).”*

Konsiderojmë se kërkesa e përcaktuar në këtë mënyrë është e paqartë, joprecize dhe në kundërshtim me vetë natyrën e mjetit të kërkuar.

Pas verifikimeve të bëra dhe informatave të kërkuara pranë institucioneve përkatëse, respektivisht qendrave për regjistrimin e automjeteve, rezulton se formulimi **“kamion me peshë totale maksimum 1t”** nuk është në përputhje me kategorizimin përkatës të mjeteve. Vetë nocioni **“kamion”**, sipas legjislacionit përkatës të transportit, ndërlidhet me mjete me masë/peshë mbi **3.5 ton**, ndërsa Autoriteti Kontraktues në të njëjtën kërkesë ka kërkuar **“kamion me konstruksion kiper”** dhe njëkohësisht ka kufizuar peshën totale të tij në maksimum 1 ton.

Rrjedhimisht, kërkesa e vendosur nga Autoriteti Kontraktues përmban një kundërtënie të drejtpërdrejtë: nga njëra anë kërkohet **kamion me konstruksion kiper**, ndërsa nga ana tjetër kërkohet që **pesha totale e këtij kamioni të jetë maksimum 1 ton**.

Konsiderojmë se ka mundësi që Autoriteti Kontraktues me kërkesën prej **1 ton** të ketë synuar kapacitetin bartës/ngarkues të automjetit kamionit ose kamionetes dhe jo peshën totale të tij.

Në këtë drejtim, Neni 25.17 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik – versioni i konsoliduar, përcakton se **të gjitha kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë**.

Gjithashtu, Neni 19.4 i Rregullores përcakton se përshkrimi i specifikimeve teknike/termave të referencës duhet të jetë **i qartë, i saktë dhe preciz**, nuk duhet të paraqesë kufizime të paarsyeshme në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca dhe nuk duhet të krijojë paqartësi rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.

Kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues që këtë kërkesë ta rishqyrtojë dhe korrigjojë, duke përcaktuar qartë dhe saktë karakteristikat e mjetit të kërkuar dhe, nëse qëllimi i Autoritetit Kontraktues ka qenë përcaktimi i kapacitetit bartës/ngarkues prej 1 ton, atëherë kjo të përcaktohet shprehimisht si e tillë dhe të largohet formulimi **“peshë totale maksimum 1t”**.

Pergjigja e AK ka qene joproportionale dhe jo adekuate sa i perket kesaj kerkese ku AK ne pergjigje ka thene se

“gjithashtu, kërkesa nuk është diskriminuese dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi në treg ekzistojnë mjete të ndryshme me konstruksion kiper dhe kapacitet bartës afërsisht 1 ton, të cilat mund të përdoren për realizimin e kontratës”

Edhe pse ne pergjigje ka thene qe kamioni duhet te kete peshe bartese 1 ton , ne dosjen e tendrit vazhdon te figuroje peshe totale 1 ton, kjo eshte e pakutimte duke e pasur parasysh qe nje automjet i thjesht peshon me shume se 1 ton e lere nje makineri pune kamion te kete peshetotale 1 ton max,

Kerkojme nga panely shqyrtues qe kerkesen kamion kiper me peshe totale max 1 ton te zevendesohet me peshe totale min 1 ton.

PRETENDIMI 2

Kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë si më poshtë:

“Gjysërrimorkio kiper kran me sinjalizues të punimeve me peshë totale maksimum 3.5t.”

Kërkesa e lartcekur është **konfuze, e paqartë dhe tejet kufizuese**, si në aspektin e emërimit të mjetit ashtu edhe në karakteristikat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Fillimisht, AK ka kërkuar **gjysërrimorkio**, ndërsa askund në këtë kërkesë dhe në listën e mjeteve të Dosjes së Tenderit nuk ka kërkuar **kokë tërheqëse** për tërheqjen e saj. Logjikisht shtrohet pyetja se si është paraparë të përdoret gjysërrimorkioja për realizimin e punimeve pa mjetin përkatës tërheqës. Nëse qëllimi i AK-së ka qenë të kërkojë **rimorkio**, atëherë duhet të korrigjohet emërtimi nga “gjysërrimorkio” në “rimorkio”, pasi kemi të bëjmë me mjete të ndryshme dhe Operatorët Ekonomik nuk mund të supozojnë se çfarë mjeti ka pasur për qëllim AK.

Përveç kësaj, AK ka bashkuar disa karakteristika specifike në një mjet të vetëm, duke kërkuar **gjysërrimorkio me konstruksion kiper, me kran dhe me sinjalizues të punimeve**, si dhe duke ia kufizuar peshën totale në **maksimum 3.5 ton**. Kombinimi i të gjitha këtyre karakteristikave në një mjet të vetëm e bën kërkesën tejet specifike dhe kufizuese, ndërsa nuk është sqaruar arsyeja apo domosdoshmëria që punët përkatëse të kryhen vetëm me një mjet me këtë konfigurim.

Qëllimi i kërkesës duhet të jetë sigurimi i kapacitetit teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës dhe jo kufizimi i Operatorëve Ekonomik në një konfigurim të rrallë dhe specifik të një mjeti, nëse të njëjtin funksion dhe të njëjtat punë mund t'i kryejë një mjet tjetër ekuivalent.

Për këtë arsye, konsiderojmë se të njëjtën detyrë mund ta realizojë edhe një **kamion me konstruksion kiper dhe kran**, ndërsa duke iu referuar kufizimit të vendosur nga vetë AK prej maksimum **3.5 ton**, mund të pranohet edhe **kamionetë me konstruksion kiper dhe kran**, me kusht që mjeti të posedojë karakteristikat dhe kapacitetin e nevojshëm për realizimin e punimeve.

Kërkesa në formën aktuale kufizon pa nevojë mundësinë e konkurrimit të Operatorëve Ekonomik të cilët posedojnë mjete që e kryejnë funksionin e njëjtë, por nuk e kanë pikërisht emërtimin dhe konfigurimin e përcaktuar nga AK.

Andaj **kemi kerkuar nga Autoriteti Kontraktues që ta rishikojë dhe korrigjojë këtë kërkesë**, duke sqaruar fillimisht nëse kërkohet gjysërrimorkio apo rimorkio dhe, në rast se mbetet kërkesa për gjysërrimorkio, të përcaktojë edhe mënyrën/mjetin e paraparë për tërheqjen e saj. **Gjithashtu kërkohet që të lejohet ofrimi i një mjeti ekuivalent që përmbush të njëjtin funksion** dhe nevojat e projektit, përkatësisht kamion me konstruksion kiper dhe kran apo kamionetë me konstruksion kiper dhe kran, duke respektuar kërkesat funksionale të nevojshme për realizimin e kontratës.

Edhe per kete kerkese autoriteti kontraktues e ka refuzuar me arsyetimin se :

Sa i përket pajisjes Gjysmë-rimorkio kiper me sinjalizues të punimeve me peshë totale maksimum 3.5 t, refuzohet si i pabazuar. Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesa e përcaktuar në Dosjen e Tenderit për "Gjysmërimorkio kiper me sinjalizues të punimeve me peshë totale maksimum 3.5 t" është përcaktuar në përputhje me nevojat reale dhe objektin e kontratës, si dhe me kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Pretendimi se specifikimi është konfuz apo kufizues vetëm për faktin se është kërkuar një gjysmë-rimorkio kiper me kran nuk qëndron. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përcaktojë karakteristikat teknike të mjetit që i nevojitet për realizimin e qëllimit të kontratës, për sa kohë që këto kërkesa lidhen drejtpërdrejt me nevojat dhe objektin e prokurimit. Sa i përket pretendimit për mungesën e kokës tërheqëse, Autoriteti Kontraktues sqaron se kjo nuk e bën kërkesën të paqartë. Nëse në kuadër të kontratës kërkohet një gjysmë-rimorkio, mënyra e sigurimit dhe përdorimit të saj mund të realizohet në përputhje me konfigurimin dhe kapacitetin teknik të kërkuar. Për më tepër, operatorët ekonomikë kanë mundësi të ofrojnë zgjidhjen teknike që përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e

Tenderit. Gjithashtu, kërkesa për peshë totale maksimale 3.5 ton, si dhe për pajisjen me konstruksion kiper, kran dhe sinjalizues të punimeve, është përcaktuar për të garantuar që mjeti i ofertuar të jetë i përshtatshëm për përdorimin dhe punët për të cilat Autoriteti Kontraktues ka nevojë. Këto kërkesa nuk janë vendosur për të favorizuar një operator ekonomik të caktuar, por për të siguruar kapacitetin dhe funksionalitetin e nevojshëm të mjetit. Në këtë kuptim, fakti që një operator ekonomik mund të ketë në dispozicion një mjet tjetër, si kamion me konstruksion kiper dhe kran, nuk nënkupton domosdoshmërisht se ai mjet është teknikisht dhe funksionalisht i njëjtë me mjetin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

- I. APROVOHET**, si e bazuar ankesa e **VED GROUP SHPK**
- II. Korrigjohet** dosja e tenderit e datës 10.07.2026 sa i përket pretendimeve të lartëcekura.
- III.** Të korrigjojë kërkesën “Kamionë me konstruksion kiper me peshë totale maksimum 1t”, duke përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të saktë peshën dhe/ose kapacitetin bartës të mjetit të kërkuar;
- IV.** Të korrigjojë kërkesën “Gjysëmrimorkio kiper kran me sinjalizues të punimeve me peshë totale maksimum 3.5t”, duke sqaruar saktë llojin dhe karakteristikat e mjetit të kërkuar dhe të lejojë ofrimin e automjetit ekuivalent i cili përmbush të njëjtin funksion dhe nevojat e projektit;

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve na janë shkaktuar dëme në vlerë rreth 6 mijë euro deri më tani.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përfuthe me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përfuthe me nenin 118 të LPP-se, dhe

- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.